

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1014 Prot.

Tiranë, më 27.09 2016

VENDIM Nr. 108, datë 14.09.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11 të datës 14.09.2016, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të *projektit të përshtatjes së godinës së konvikteve të shkollave të mesme për Gjykatën Administrative të Apelit*, Tiranë- subjekti ZABGJ, realizuar nga Agjensia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të *projektit të përshtatjes së godinës së konvikteve të shkollave të mesme për Gjykatën Administrative të Apelit*, Tiranë- subjekti ZABGJ, realizuar nga Agjensia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO